

BIRRA PEJA, JETZ AUCH IM COOP UND OTTO'S ERHÄLTlich



albinfo.ch
Aktualiteti i Shqiptarëve në Zvicër

E hënë, 30 Shtator, 2013 - 10:09

Shqip | Deutsch | Français

Albnews E-Diaspora Jeta në Zvicër CH-Ballkani Shërbime Albinfo.tv Fun

Një ditë plot veprimtari dhe emocione

03.07.2013 - 08:22

ABSM dhe FC Dardania organizuan një veprimtari gjerë-përfshirëse sportive në Allschwil me moton "Sporti flet një gjuhë"



1 2 3 4

Ditën e dielë, më 23 Qershor 2013, nga ora 9.00-18.00, në stadiumin Bachgraben-Allschwil, u organizua Turneu tradicional sportiv nën moton „Sporti flet një gjuhë”. Ishte një ditë plot veprimtari sportive dhe argëtuese për qytetarë vendas e për emigrantë e azilkërkues, që janë vendosur në Allschwil. Vlen të theksohet se në këtë ngjarje sportive kanë marrë pjesë disa mysafirë të shquar nga politika dhe sporti.

Siç është bërë prej vitesh një traditë e bukur, Qendra e Edukimit dhe Këshillimit për emigrantët (ABSM) dhe FC Dardania organizuan edhe këtë vit një veprimtari gjerë-përfshirëse sportive në fushën e Allschwilit. Me këtë rast, nga pjesëmarrja e banorëve vendas dhe e emigrantëve nga vende të tjera, u shpreh edhe njëherë qartë mesazhi se "Sporti flet një gjuhë". Rregullat botërore sportive janë të njëjta dhe të gjithë mund t'i kuptojnë dhe respektojnë ato. Organizatorët dhe pjesëmarrësit shprehën besimin se sporti ka shumë mundësi të krijojë lidhje ndër-kulturore midis qytetarëve vendas dhe të bashkësive të emigrantëve. Duke gjetur dhe theksuar ngjashmëritë gjatë veprimtarive të tilla sportive ndihmohet dhe arrihet për të ndërtuar ura bashkëpunimi dhe për rrëzimin e paragjyqimeve.

Veprimtari zbatimëse për të gjithë

Gjatë gjithë ditës, u organizuan aktivitete të ndryshme sportive, si një turne i gjerë

Reklamë

A sjell alkooli probleme...

... në marrëdhënie?
... në familje?
... në vendin e punës?

Shëndeti i Bernës (Berner Gesundheit) ju këshillon falas. Pyetjet tuaja do të trajtohen në besim.

Ne punojmë me përkthime ndërkulturore në bashkëpunim me Compendin.

Tel. 031 370 70 70 | bern@beges.ch
www.bernergesundheits.ch

Berner Gesundheit
Santé Bernoise

Reklamë

Platforma televizive shqiptare!

TOPAL
Gjërat që të bashkojnë

Presented by **DIGITALB**



Të rinjtë e Biel Bienne formojnë shoqatën "Rinia Humanitare në Zvicër"

Pavarësisht se të rinjtë jetojnë në Zvicër, mendja e zemra e tyre është atje larg në Kosovë, atje nga i kanë rrënjët...



Hidrocentrali "Ura e Shenjtë", projekt i përbashkët Kosovë -Zvicër

"Edelweiss Energy", një firmë e krijuar me kapital të përbashkët të investitorëve nga Kosova dhe Zvicra, po punon në planifikimin e ndërtimit të hidrocentralit në lumin e Drinit të Bardhë në Rahovec

futbolli, me 40 skuadra pjesëmarrëse; lojëra voleybolli për burra, gra dhe fëmijë si dhe një turne futbolli për fëmijë. Gjithashtu, sipas programit, u organizua edhe një garë vrapimi në 100 metra për fëmijët deri në dymbëdhjetë vjeç, gjatë të cilës fëmijët pjesëmarrës treguan dëshirë dhe ambicie për të fituar dhe për t'u argëtuar. Në finalen e turneut të futbollit fitoi ekipi i HBadalli, që ishte padyshim më i përgatituri dhe më i miri.

Mysafirë nga politika dhe sporti

Në këto veprimtari ishin të pranishëm si mysafirë edhe disa figura të shquara nga politika dhe sportet. Kështu në këtë ngjarje të larmishme sportive merrnin pjesë Urs Wüthrich-Pelloli (i cili bëri hapjem e këtij manifestimi), drejtues i Departamentit sportiv dhe kulturës në Këshillin regjional të Basel-Landit, Nicole Jacobs, drejtuese e Departamentit për Diversitet dhe Integrim në Basel si dhe Komisioneri për Integrim i Shoqatës Zvicerane të Futbollit të Zvicrës Veri-Perendimore, Hasan Kanber, i cili pati nderin të hapte zyrtarisht këtë ditë të mbushur me veprimtari. Përveç kësaj, ishin të pranishëm edhe futbollisti Muhamed Demiri (FC St Gallen) dhe ish- lojtari i ekipit kombëtar dhe i Superligës së Zvicrës, Milaim Rama. Ky i fundit luajti edhe si kapiten i një ekipi pjesëmarrës.

Larmi ushqimesh, pijesh dhe informacioni

Gjatë gjithë ditës, ka pasur një ofertë të pasur me ushqime dhe pije, si për lojtarët ashtu edhe për spektatorët. Nga kabinat e informacionit të ABSM dhe GGG Ausländerberatung (Këshillit për të Huajt) pjesëmarrësit informoheshin për oferta të ndryshme dhe për çështje të integritimit. Për më tepër, një grup artistik amator, i përbërë nga nxënës të shkollës së Vallëzimit "Shota", dha një shfaqje, që u pëlqye nga gjithë të pranishmit dhe e bëri edhe më tepër entuziaste atmosferën. Ngjarja u shoqërua edhe nga Televizioni publik i Kosovës, RTK.

Moderimi u koordinua nga zonja Caroline Schütz, nga Qendra e Edukimit dhe Këshillimit për emigrantët (ABSM) dhe Remzi Ferati nga Klubi i Futbollit "Dardania"

(Përgatitur nga: Caroline Schütz, nga Qendra e Edukimit dhe Këshillimit për emigrantët (ABSM) dhe Enver Hajdari, nga Klubi i Futbollit "Dardania")

Comment form

Emri juaj

Comment *

- No HTML tags allowed.
- Adresat web dhe adresat e-mail konvertohen automatikisht në lidhje.
- Rreshtat dhe paragrafët shkojnë automatikisht në krye.

[More information about text formats](#)

RUAJ SHIKOJE



"Food Festival": Gatimi shqiptar, në mesin e 29 vendeve të botës

Të shtunën janë ofruar ushqime tradicionale të 29-të vendeve të botës në Opfikon-Glattbrugg të Cyrihut, në mesin e tyre edhe ato shqiptare



Shërbimet shëndetësore përtej barrierave gjuhësore

Mosnjohja e gjuhës nuk guxon të jetë pengesë për shfrytëzimin e shërbimeve kualitative shëndetësore, u tha veç tjerash në Konferencën Nationale për Shëndetësinë dhe Migracionin



Ballkani ende larg politikave për energjitë e ripërtërishe

Konferenca për energjitë e ripërtërishe në Ballkan, organizuar nga albinfo.ch ka arritur të mbledhë një numër imponant të ekspertëve, përfaqësuesve të institucioneve vendimmarrëse në këtë fushë dhe ka hedhur dritë mbi sfidat para të cilave gjenden shoqëritë e Ballkanit sa i përket energjisë dhe mbrojtjes së ambientit.



Tearca e Zvicrës feston përvjetorin me miq

Ka qenë mbi të gjitha angazhimi dhe vetë emri i dr. Omer Xhemailit, kardiologut të famshëm shqiptar, ai që ka mbledhur më së shumti mysafirë në këtë mbrëmje

Reklamë _____